

Albanian Version



HERTFORDSHIRE
Modern Slavery Partnership

HYRJE NË NDIHMË SHI NJË VIKTIMË E SKLLAVËRISË MODERNE

(PËR TË RRRITUR)



west midlands
police and crime
commissioner



HERTFORDSHIRE
Modern Slavery Partnership



WEST
MIDLANDS
ANTI SLAVERY
NETWORK

MBËSHTETJA KOMBËTARE DHE VENDORE (OPSIONI 1): MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT (NRM)

Mekanizmi Kombëtar i Referimit (NRM) është një sistem për identifikimin dhe referimin e të mbijetuarve të mundshëm të skllavërisë moderne dhe për të siguruar që ju të merrni mbështetjen e duhur. Ju keni mundësinë për të marrë këtë mbështetje brenda apo jashtë Hertfordshire.

Nëse dëshironi që Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar t'ju njohë si viktimë e skllavërisë moderne, ju mund të kërkonti që ata ta shqyrtojnë kërkesën tuaj duke i kërkuar një punonjësi të shërbimit parësor të paraqesë një kërkesë pranë NRM-së.

Vendimmarrësit e trajnuar në Ministrinë e Brendshme (Home Office) shqyrtojnë kërkesën tuaj për të vendosur nëse besojnë se jeni viktimë e skllavërisë moderne, Vendimmarrësit së pari do të vendosin nëse ka "baza të arsyeshme" për të dyshuar nëse jeni viktimë e skllavërisë moderne. Ata synojnë ta marrin vendim e parë brenda 5 ditëve, dhe ju keni të drejtë për akomodim urgjent gjatë kësaj kohe nëse jeni të pastrehë.

Nëse merrni një vendim pozitiv në baza të arsyeshmërisë, ju keni të drejtë për një nivel të caktuar mbështetjeje nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Ju nuk mund të hiqeni nga Mbretëria e Bashkuar përsa kërkesa juaj është nën konsiderim.

Ju keni të drejtë për një minimum prej 45 ditësh pushim dhe periudhë reflektimi, për disa njerëz kjo mund të zgjasë shumë më gjatë. Gjatë kësaj kohe, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar do të mbledhë më shumë informacione rreth jush dhe do të marrë një vendim përfundimtar (në "Baza Përfundimtare") nëse ata besojnë se ju jeni viktimë e skllavërisë moderne. Nëse merrni një vendim pozitiv të Bazuar Përfundimtar që ju konfirmon se Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ju beson se jeni një viktimë e skllavërisë moderne, atëherë mund të keni të drejtë në mbështetje shtesë për t'u rikuperuar.

Nëse nuk jeni ende gati ta merrni këtë vendim, mund të kërkonti të referoheni në të ardhmen.
Nëse jeni në rrezik abuzimi ose keni nevojë për kujdes dhe mbështetje, mund të keni të drejtën e mbështetjes së autoritetit tuaj lokal nën Kuadrin e Aktit të Kujdesit (2014).

Skllavëria moderne konsiderohet një krim i rëndë në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo mund të marrë shumë forma të ndryshme, por mund të përfshijë shfrytëzimin seksual, punën e detyruar, shfrytëzimin kriminal, servitutit shtëpiak, marrjen e organeve dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Trafikimi i qenieve njerëzore është rekrutimi, lëvizja ose marrja e një personi me mashtrim ose detyrim në një situatë shfrytëzimi. Ndoshta ju kanë thënë që do të vini në Mbretërinë e Bashkuar për të punuar ligjërish, por pasi keni ardhur këtu jeni detyruar të punoni me kërcënime nëse refuzoni.



OPSIONET PËR PËRKUJDESJE DHE MBËSHTETJE NË NRM:

Mbështetje ne Terren (Në Hertfordshire) ose Akomodim dhe Mbështetje financiare (Jashtë Hertfordshire)



Nëse në NRM ju jepet një vendim pozitiv ne bazat e arsyeshmërisë, agjensitë speciale mund t'ju ofrojnë mbështetje. Kontraktori i Kujdesit për Viktimat (KKV) mund t'ju referojë tek një organizatë mbështetëse, e cila do t'ju ndihmojë të keni qasje në:

Nëse jeni të pastrehe dhe nuk keni të drejtën e akomodimit, ose nëse është me rrezik për ju që të qëndroni atje ku jetoni aktualisht, mund të hyni në strehim të përkohshëm të sigurt në një zonë tjetër në Angli.

Nëse tashmë keni diku të sigurt për të jetuar, ose keni të drejtën e akomodimit ose nuk pranoheni në një strehim të sigurt, agjencitë e specializuara të ndihmës mund t'ju ofrojnë ndihmë në terren. Do t'ju jepet një punonjësi i çështjes nga një organizatë lokale specialiste që do të vizitojë dhe ju ofrojë mbështetjen e përmendur më lart.

Nëse akomodimi është në Hertfordshire, atëherë punonjësi i çështjes do të caktohet nga organizata e bamirësisë, Migrant Help. Migrant Help ka përvojë të konsiderueshme në mbështetjen e njerëzve me prejardhje dhe nacionalitete të ndryshme, të cilët kanë përjetuar shfrytëzim seksual/familjar/të punës/kriminal.



Nëse dëshironi të referoheni në NRM

Punonjësja juaj parësore do të plotësojë një referim NRM-mi me ju. Një punonjës parësor është një profesionist i disa organizatave të caktuara që janë të trajnuar për të bërë referime në NRM, siç janë:



Policia



Autoritetet lokale



Ministria e Brendëshme



Bamirësi të specializuara

Nëse jeni i rritur (mbi 18 vjeç) do t'ju duhet të jepni aprovimin të referoheni në NRM. Duke aprovuar referimin në NRM, ju gjithashtu pranoni që informacioni juaj të shperndahet me autoritetet përkatëse, siç janë departamentet e Mistrisë së Brendshme dhe Policia. Ju nuk keni nevojë të raportoni në Polici, por ata mund t'ju kontaktojnë dhe t'ju pyesin nëse doni mbështetje për ta bërë këtë.

Do t'ju kërkohet informacioni juaj personal, një llogari e ngjarjes që ju ka ndodhur dhe udhëtimi juaj në dhe/ose përreth MB-së. Respondentët parësor janë të trajnuar të identifikojnë treguesit e trafikimit njerëzor dhe skllavërisë moderne për të shkruar informacione në mbështetje të kërkesës tuaj.

Respondenti Parësor duhet t'ju lexojë gjithçka që ka shruar për ju për të siguruar që është e saktë dhe ju duhet të kërkonte një kopje të kësaj forme për veten tuaj.

Ju mund të zhvendoseni në akomodim të përkohshëm ndërsa vazhdon ky proces dhe do të informoheni nëse duhet të largoheni nga ai strehim kur të merrni vendimin tuaj të me baza të arsyeshme.

Nëse merrni një RG (BtA) negative në këtë fazë - shikoni seksionin në jo-NRM, gjithashtu mund të kërkonte nga respondenti parësor juaj që të apelojë këtë vendim nëse keni prova shtesë në mbështetje të pretendimit tuaj.

KËSHILLA LIGJORE

Me një vendim pozitiv të arsyeshëm ose konkluziv me baza të arsyeshme, ju keni të drejtën e ndihmës juridike falas në disa forma veçanta.

Nëse është e nevojshme, ju mund të diskutoni opsionet tuaja të emigracionit dhe të merrni disa këshilla juridike të tjera. Nëse nuk keni status në Mbretërinë e Bashkuar, duhet të filloni të mendoni për opsionet tuaja të imigracionit.

Ju duhet të mblidhni informacione që mund t'ju ndihmojnë në plotësimin e një aplikacioni dhe të kërkonte këshilla juridike në lidhje me opsionin më të përshtatshëm për ju.



NËSE MERRNI NJË VENDIM POZITIV PËR 'BAZAT KONKLUZIVE' (CG)



Nëse merrni një vendim pozitiv për 'Bazat Konkluzive' (CG)

Kjo konfirmon që Qeveria beson se ju jeni viktimë e skllavërisë moderne, ofruesi juaj i përkrahjes do të bëjë një vlerësim të nevojave tuaja të rimëkëmbjes. Ky vlerësim është për të siguruar që ju të mos largoheni nga mbështetja derisa të keni arritur një nivel të arsyeshëm të rimëkëmbjes dhe të mund të kaloni me siguri në mbështetjen e një organizate tjetër.

Kjo perjudhë do të jetë 45 ditë minimum mbështetje shtesë.

Nëse merrni një vendim përfundimtar negativ (CG), Kjo do të thotë që Qeveria nuk ka gjetur prova të mjaftueshme që tregojnë se ju jeni një viktimë e skllavërisë moderne. Ju do të keni 9 ditë mbështetje për të lëvizur jashtë kujdesit të organizatës mbështetëse dhe për të hyrë në shërbime mbështetëse të tjera, nëse keni nevojë për to. Shikoni informacionin e mëposhtëm për më shumë detaje rreth mbështetjes që mund të merrni.



Nëse nuk jeni dakord me vendimin për arsyet e bazuara përfundimtare dhe besoni se ajo çfarë keni kaluar plotëson përcaktimin e skllavërisë moderne, mund të kërkonti nga ofruesi juaj i mbështetjes, përfaqësuesi ligjor ose përgjegjesja parësore që t'ju mbështesë të dërgoni një kërkesë rishqyrtimi të çështjes. Ju mund të përfshini çdo informacion që mendoni se mungonte kur u mor në konsideratë kërkesa juaj. Ju do të vazhdoni të merrni mbështetjen derisa të konsiderohet rishqyrtimi i çështjes.

LARGIMI NGA MBËSHTETJA NRM

Kur vjen koha për t'u larguar nga mbështetja e NRM, punonjësi juaj mbështetës do të bëjë plane me ju për t'ju siguruar se e dini se ku do të shkoni dhe se keni një plan të caktuar për t'u larguar.

Nëse merrni një vendim përfundimtar pozitiv

Pasi që të largoheni nga mbështetja e NRM, ju gjithashtu do të keni qasje në mbështetjen afatgjate të quajtur "Reach In", nëse keni nevojë për mbështetje për të ruajtur pavarësinë tuaj ose për të marrë ndonjë këshillë siç është ndihmë për të gjetur një punë, këshillim apo ndonjë terapi tjetër, kurse anglishteje (ESOL) dhe shërbime të përkthimit.

Për të qasur këtë ndihmë, ju duhet të telefononi The Salvation Army në 0800 808 3733 dhe të kërkonti një formular referimi. Formulari është në gjuhën angleze dhe ndoshta ju do të keni nevojë që t'i kërkonti një profesionisti për ta plotësuar formularin me ju. Për çdo kërkesë mbi të dhënat tuaja, të cilat mbahen në The Salvation Army, ju lutem dërgoni email në: data.protection@salvationarmy.org.uk.

Nëse nuk hyni në mekanizmin e NRM-it Ose nëse merrni një vendim negativ të arsyeshëm (RG) ose arsyesh përfundimtare (CG).

Skllavëria moderne është një lloj krimi shumë specifik, marrja e një vendimi negativ nuk mund të thotë se çfarë ju ka ndodhur nuk besohet, por do të thotë se çfarë ju ka ndodhur nuk përputhet me kriteret e skllavërisë moderne dhe ju mund të keni të drejtë të përdorni mbështetje tjetër.

Nëse jeni në rrezik abuzimi ose keni nevojë për kujdes dhe mbështetje, mund të keni të drejtën e mbështetjes së autoritetit tuaj lokal nën Kuadrin e Aktit të Kujdesit (2014).

MBËSHËTETJA VENDORE (OPSIONI 2): BEACON



Nëse nuk dëshironi ta përfshini qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar ose policinë, atëherë Hertfordshire ka një shërbim lokal mbështetës të quajtur Beacon, i cili është i ndarë nga qeveria dhe policia. Ju mund të merrni mbështetje nga Beacon dhe nuk është e nevojshme të bashkëpunoni me policinë ose me qeverinë. Detajet tuaja do të mbahen po ashtu konfidenciale.

'Do t'ju caktohet një menaxher i çështjes i trajnuar në mënyrë të posaçme që:

- Do t'ju mbështesë gjatë rikuperimit tuaj nëpërmjet një plani të individualizuar të mbështetjes.
- Do të veprojë si avokati juaj (Mbështetje emocionale dhe praktike).
- Do t'ju referojë te partnerët me aftësi dhe
- njohuri të specializuara që mund t'ju mbështesin më mirë (nëse e pranoni këtë).
- Mbështetje për garantimin e sigurisë suaj personale.

Nëse nuk e pranoni mbështetjen nga Beacon, kini parasysh se shërbimi është gjithmonë i hapur për ju dhe mund të referoheni vetë nëpërmjet faqes së internetit (www.hertfordshirebeacon.org) ose në numrin 03000 11 55 55 (opsioni 3).

Faqja e tyre e internetit siguron informacione të dobishme për trajtimin e efekteve të shfrytëzimit dhe për njohjen e procesit të drejtësisë penale. Ajo ka po ashtu detaje për agjenci të tjera lokale në Hertfordshire që mund t'ju ofrojnë mbështetje.

Linja e Ndhmës për Skllavërimin dhe Shfrytëzimin Modern



Mund të referoheni vetë në Linjën telefonike kombëtare të ndihmës për skllavërimin moderne e disponueshme në 24 orë në numrin 08000 121 700, e cila mund t'ju ofrojë këshilla të menjëhershme në mbi 200 gjuhë. Kjo linjë telefonike e ndihmës drejtohet nga një organizatë bamirëse, Unseen, dhe është e pavarur, profesionale dhe e besuar. Ashtu si me Beacon, mund të merrni mbështetje nga linja telefonike e ndihmës pa qenë e nevojshme të keni lidhje me policinë ose me qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar.

OPSIONET E IMIGRACIONIT DHE KËSHILLAT LIGJORE (IMAZHI)

Nëse nuk keni të drejtë ligjore të qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar, duhet të filloni të mendoni për opsionet tuaja të imigracionit. Ju duhet të mblidhni informacione që mund t'ju ndihmojnë në plotësimin e kërkesës për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar nëse dëshironi ta bëni këtë dhe duhet të kërkonti këshilla ligjore për opsionin tuaj më të përshtatshëm.

Ju mund ose nuk mund të keni të drejtë ndihme financiare për të marrë këshilla ligjore, ju duhet të merrni këshilla vetëm nga këshilltarët e kualifikuar ligjorë, ata mund t'ju ofrojnë ndihmë ligjore falas në disa mënyra. Gjithmonë duhet të kontrolloni paraprakisht nëse këshilltari juaj ligjor kërkon pagesa për shërbimin.

Mund të gjeni një këshilltar të imigracionit duke vizituar faqen www.gov.uk dhe të kërkonti për 'këshilltar të imigracionit (immigration adviser)'. Përndryshe, mund të kontaktoni Zyrën e Komisionerit të Shërbimeve të Emigracionit (OISC):



Është e paligjshme që dikush të ju japë këshilla nëse ato nuk janë të kualifikuar ose të regjistruar dhe rrezikoni që këshillat e tyre të mos jenë të sakta ose përkohësore.


Nëse dëshironi të ktheheni në shtetin tuaj të origjinës, Shërbimi për Kthime Vullnetare i Misintrisë së Brendshme mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë të ktheheni në shtëpi. Ju mund t'i kontaktoni ata në 0300 004 0202. Ekipi do të diskutojë kthimin tuaj dhe mbështetjen që mund t'ju nevojitet. Nëse është e pa rrezik për ta bërë këtë, ju mund gjithashtu të kontaktoni Ambasadën tuaj për ndihmë.

SHËNDETËSIA

Çdo person mund të regjistrohet me një praktikë mjeku familjar si një pacient i NHS.

Kujdesi parësor është falas (p.sh). Mjeku familjar (GP) ose trajtimi mjekësor urgjent.

Disa lloje kujdesi mjekësor to NHS-it nuk do të jenë të falas dhe mund t'ju kërkohet të paguani para se te merrni keto trajtimeve mjekësore – duhet të pyesni një profesionist mjekësor çdo pyetje në lidhje me të drejtën tuaj, nëse nuk jeni i sigurt. NHS mund të kontrollojë statusin tuaj të imigracionit me Ministrinë e Brendëshme në qoftë se ata janë të pasigurt në lidhje me statusin tuaj, ata duhet t'ju venë në dijeni nëse kjo ndodh dhe mund t'ju japin informacione në lidhje me këtë proces.



QASJE NË STREHIM

Nëse jeni normalisht rezident në Mbretërinë e Bashkuar ose keni disa lloje leje qëndrimi në MB, mund të keni të drejtën e strehimit në MB dhe kjo përfshin shërbime për njerëz të pastrehë.

Nëse nuk keni status qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar, mund të mos keni të drejtën e akomodimit dhe mund të keni vështirësi për të hyrë në akomodim. Ju duhet të kontaktoni ekipin lokal të strehimit për këshilla.

Ju mund të përdorni këshillat nga Byroja e Këshillimit të Qytetarëve ose nga një përfaqësues ligjor në lidhje me të drejtat dhe të perkatësitë tuaja.

HYRJA NË NDIHMAT E MIRËQENIES

Nëse e keni marrë statusin, një formë leje për të qëndruar si Statusi i Refugjatëve ose Mbrojtjen Humanitare, ose të drejtën si rezident në Mbretërinë e Bashkuar, ju mund të keni të drejtë të aplikoni për ndihmë të mirëqenies nga Qeveritëria, e quajtur Kredi Universale. Ju mund të merrni këshilla nga Byroja e Këshillimit të Qytetarëve, Uebfaqja e Qeverisë ose nga një ofrues i ndihmës ligjore për të diskutuar nëse ju përket të aplikoni për ndihmën e mirëqenies.

Mbështetja për azilkërkuesit

Nëse jeni një azilkërkues ose dëshironi të paraqisni një kërkesë për azil, ju mund të keni të drejtë në Ndhmën Kombëtare të Kërkuesit të Azilit (NASS), shikoni fletën e informacionit për detajet e kontaktit. Këshillohet që të keni marrë këshillat ligjore përpara se të bëni kërkesën për azil.

MBËSHTETJE

Mund të referoheni vetë te Beacon në numrin 03000 11 55 55 (opsioni 3). Faqja e tyre e internetit (www.hertfordshirebeacon.org) siguron informacione të dobishme për trajtimin e efekteve të shfrytëzimit dhe për njohjen e procesit të drejtësisë penale. Ajo ka po ashtu detaje për agjenci të tjera lokale në Hertfordshire që mund t'ju ofrojnë mbështetje emocionale dhe praktike.



YOUR NOTES

A large white rectangular area with a dashed black border, intended for taking notes.